

**Emri i biznesi:** "Radio Kalabria" SH.P.K.  
**Numri Unik Identifikues:** 810154948  
**Pronare:** Ismete MEHMETAJ  
**OSHMA:** Radio KALABRIA  
**Adresa:** Sokol Mehmetaj p.n., Istog

**Emri i biznesit:** "Radio Istogu" SH.P.K.  
**Numri Unik Identifikues:** 810139403  
**Kandidati për pronar:** Liridon LIPAJ  
**OSHMA:** Radio KALABRIA  
**Adresa:** Rr/ Rinia p.n., Istog

## VENDIM


për ndryshimin e pronësisë dhe bartjen e licencës së Radio Kalabria si dhe ndryshimin e emrit në Radio West - me seli në Komunën e Istogut

### Fakte

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.
2. Radio Kalabria është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio (Radio), me mbulim lokal, i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur i Mediave për transmetim tokësorë të programeve, në gjuhën shqipe dhe me seli në komunën e Istogut. Radio Kalabria është pajisur me licencë të KPM-së me datën 17 maj 2019, me afat prej shtatë (7) vitesh.
3. Me datën 27 gusht 2020, Radio Kalabria ka dorëzuar në zyrën e KPM-së, një kërkesë përmes së cilës ka kërkuar miratimin për ndryshimin e pronësisë së radio stacionit dhe bartjen e licencës nga biznesi "Radio Kalabria" SH.P.K., me Numër Unik Identifikues (NUI) 810154948 dhe me pronaren znj. Ismete Mehmetaj, tek, biznesi "Radio Istogu" SH.P.K me Numër Unik Identifikues 810139403 dhe me pronar Liridon Lipaj.
4. Më datën 22 tetor 2020, kandidati për pronar të Radio Kalabria ka parashtruar një kërkesë për ndryshimin e emrit të Radio Kalabria në Radio West.

### Arsyetim

5. Neni 21, paragrafi 3 i Ligjit të KPM-së përcakton se: "*licencat nuk mundë të shfrytëzohen dhe bartën pa autorizim dhe pa aprovim paraprakë me shkrim të KPM-së*".
6. Neni 15. pika 2. Paragrafi 1 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: "*Për çdo ndryshim në pronësi që kap më shumë se 10% të aksioneve të interesave ose ato që kanë ndikim të theksuar në kontrollin e të Licencuarit, kërkohet paraprakisht aprovimi me shkrim nga ana e KPM-së*".



7. Neni 15.4 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: “KPM-ja do të lejojë transferimin e licencës vetëm kur sigurohet që personi fizik apo juridik, për të cilin propozohet që t’i transferohet licenca, i plotëson standardet e KPM-së për t’iu dhënë një licencë.”
8. Me anë të kërkesë për ndryshimin e pronësisë së Radio Kalabria, pronarja aktuale ka deklaruar se arsye për këtë ndryshim janë çështjet familjare.
9. Komisioni konstaton se, kandidati i propozuar për pronar të ri ka shprehur gatishmëri që, ofrimin e shërbimeve mediale audio për publikun do të bëjë në pajtueshmëri me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së. Gjithashtu, kandidati ka deklaruar se ka përvojë të gjatë pune në një radio stacion lokal si dhe ka një kohë të gjatë që ka themeluar dhe menaxhuar një radio stacion me transmetim përmes internetit.
10. Komisioni konstaton se, kandidati i propozuar për pronar të ri përmes një plani të biznesit lidhur me të hyrat, shpenzimet dhe profitin, ka paraparë investime në teknologjinë e transmetimit të Radio Kalabria në mënyrë që transmetimi i programit të jetë më kualitativ, ndërsa sa i përket qëndrueshmërisë financiare kandidati për pronar ka bashkangjitur edhe dëshmi nga institucionet financiare.
11. Duke u bazuar në gatishmërinë e shprehur të kandidatit për pronar të ri për të punuar në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së, dëshmitë rreth qëndrueshmërisë financiare si dhe përvojën profesionale të kandidatit në punën dhe menaxhimin e radios, Komisioni vlerëson se ndryshimi i pronësisë së Radio Kalabria është në interes të publikut.
12. Komisioni konstaton se ndryshimi i emrit të Radio Kalabria në Radio West nuk do të paraqet pengesa apo konfuzion tek qytetaret gjatë transmetimit të programeve të radios dhe si e tillë kërkesa i plotëson kushtet për miratim.
13. Komisioni vlerëson se, kërkesa është bërë në pajtim me procedurat e KPM-së, të bazuara në Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe si e tillë i plotëson kriteret për miratim.

### Vendim

14. Komisioni, në takimi e tij të mbajtur më datën 13 nëntor 2020, merr vendim për miratimin e kërkesës për ndryshimin e pronësisë së Radio Kalabria dhe bartjen e licencës nga biznesi “Radio Kalabria” SH.P.K., Numër Unik Identifikues 810154948 me pronaren znj. Ismete Mehmetaj, tek, biznesi Radio Istogu” SH.P.K Numër Unik Identifikues 810139403, me pronar z. Liridon Lipaj.
15. Komisioni vendos që të miratojë kërkesën e kandidatit për pronarë të Radio Kalabria për ndryshim të emrit në Radio WEST.
16. Përveç ndryshimit të pronësisë dhe emrit nuk do të ketë në ndryshime në pjesët tjera të Licencës , si Pjesës II – Parametrave Teknik, III – Formatit te Programit dhe IV – Zonës së Mbulimit.
17. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.

  
Xhevat LATIFI

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



13.11.2020  
datë